



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.260/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, dhe me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë, paraqitur kundër Enver Demiri nga Fushë Kosova, për shkak të fotografimit të votës gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 15.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.260/2017 i datës 12.06.2017 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë .

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 12 qershor 2017 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë, me të cilën pretendohet se me datën 11.06.2017, në Qendrën e Votimit QV nr.0910e/06 në shkollën fillore “Selman Riza” në Fushë Kosovë Enver Demiri e ka bërë fotografimin e votës. Për më tutje thekson se lidhur me këtë rast prokurori i shtetit pasi që e ka arrestuar të pandehurin të njëjtin e ka liruar me arsyetimin se fotografimi i votës nuk paraqet vepër penale bazuar në Kodin Penal i Republikës së Kosovës. Parashtruesi i ankesës thekson se kjo shkelje është e paraparë si vepër penale nga neni 218 “Cenim i fshehtësisë së votimit” i KPRK-së dhe Rregullës Zgjedhore nr.09/2013 nga neni 15 par.4 pra ky veprim përbën shkelje të dispozitave të lartcekura. Më këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se Herolind Sejdaç ka kryer vepër penale “Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve”, e cila parashihet sipas nenit 213 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës KPRK.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 i LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Parashtruesi i ankesës me ankesën e tij pretendon se Enver Demiri në Qendrën e Votimit QV nr.0910e/06 në shkollën fillore “Selman Riza” në Fushë Kosovë, e ka fotografuar votën e tij.

PZAP-i konstaton se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar asnjë dëshmi në cilësi të provës edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 i LZP-së për të provuar se shkelësi i supozuar e ka fotografuar votën e tij gjatë ditës së votimit në qendrën e votimit të lartcekur.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.260/2017 të datës 15.06.2017

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj



Këshillë Juridike :

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit njëzet e katër (24) orë nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi në Gjykatën Supreme të Kosovës.